

Kontrate Shit-Blerje Kuote të Shoqërisë Tregtare

Sot, në Tirane, më datë 07/05/2025, palët e mëposhtme:

1. Ortaku Znj. Natasha Xhai Toka, e bija e Spiros dhe e Anthit, e datelindjes 29.10.1952, lindur dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Durrësit", pall. 124, shk. 1, ap. 6, mbajtëse e Leternjoftimit ID nr. 033317965 dhe nr. personal **F26029054B**.

(në cilësinë e palës shitëse)

2. **Shoqëria "Innovex" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS M41505034T, me adresë "Nikolla Tupe", Pall. 2, shk. 4, Ap.26, Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Klevens Toka**, atësia Gjergj, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë rruga "Durrësit", pall. 124, shk. 1, Ap. 6, Njësia Administrative Nr. 10, Tiranë, lindur më 01.06.1978, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033902364 dhe nr. personal H80601183J.

(në cilësinë e palës blerëse)

3. **Shoqëria "TEXAS DEVELOPMENT" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS L91317004K, me adresë "Rruga e Kosovareve", Pall.Dolça, Ap.1/2, Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Olsi Efthimi**, atësia Romeo, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë rruga "Reshit Collaku", Nd. 10, H 3, Ap. 18, Njësia Administrative Nr. 10, Tiranë, lindur më 04/01/1978, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035030169 dhe nr. personal H80104094S.

4. **Shoqëria "DATON" shpk**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS K81504061N, me adresë rr. "Frosina Plaku", Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Orion Cenalla**, atësia Allaman, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë "Frosina Plaku", lindur më 09.06.1970, në Tiranë për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031409503 dhe nr. personal H00609112H.

(në cilësinë e palës dhenëse te pelqimit)

Vendosën të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 1: Objekti i kontratës

1. Ortaku i shoqërisë "GREEN LIVING COMPANY" shpk, Znj. Natasha Xhai Toka ka dakortësuar te shese 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50 (pesedhjete) % te kapitalit te shoqerise "Green Living Company" shpk, me vlere 50.000 (pesedhjete mije) leke, tek bleresi shoqëria "Innovex" shpk, sipas kushteve dhe termave të kësaj kontrate.
2. Bazuar ne vendimet e asambleve, respektivisht, vendimi i Asamblese se shoqërisë "GREEN LIVING COMPANY" shpk, vendimi i Asamblesë së shoqërisë "Texas Development" shpk dhe vendimi i Asamblesë së shoqërisë "Daton" shpk, përmes kësaj kontrate shitje:
 - a. Znj. Natasha Xhai Toka do t'i transferojë shoqërisë "Innovex" shpk, me Nuis M41505034T, 1 (nje) kuotë, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise "GREEN LIVING COMPANY" shpk me vlere 50.000 (pesedhjete mije) Leke;

Neni 2: Blerja e Kuotës nga shoqëria "Innovex" shpk

1. Shoqëria "Innovex" shpk do të blejë:



- b. 1 (nje) kuote te zoteruar nga Znj. Natasha Xhai Toka në shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke;
2. Pala shitëse, pra, Znj. Natasha Xhai Toka, heq dorë nga pronësia, nga çdo e drejtë dhe detyrim që rrjedh nga kuota e zoteruar ne shoqerine "Green Living Company" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke, duke transfereruar bashkë me pronësinë e saj tek shoqëria "Innovex" shpk.

Neni 3: Miratimi per shitjen e kuotes nga ortakët e shoqerise "Green Living Company" shpk, shoqëria "Texas Development" shpk dhe shoqëria "Daton" shpk

1. Miratimin per shitjen 1 (nje) kuote te zoteruar nga Znj. Natasha Xhai Toka në shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke tek bleresi **Shoqëria "Innovex" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS M41505034T, me adresë "Nikolla Tupe", Pall. 2, shk. 4, Ap.26, Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Klevens Toka, nga ana e ortakeve te tjere te shoqerise "Green Living Company" shpk, Shoqëria "TEXAS DEVELOPMENT" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS L91317004K, me adresë "Rruga e Kosovarëve", Pall.Dolça, Ap.1/2, Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Olsi Efthimi**, atësia Romeo, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë rruga "Reshit Collaku", Nd. 10, H 3, Ap. 18, Njësia Administrative Nr. 10, Tiranë, lindur më 04/01/1978, me Leternjoftim ID nr. 035030169 dhe nr. personal H80104094S dhe **Shoqëria "DATON" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik në QKB me NUIS K81504061N, me adresë rr. "Frosina Plaku", Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Orion Cenalla**, atësia Allaman, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë "Frosina Plaku", lindur më 09.06.1970, në Tiranë me Leternjoftim ID nr. 031409503 dhe nr. personal H00609112H, bazuar edhe ne vendimet e asamblese te shoqerive "Texas Development" shpk dhe "Daton" shpk me te cilat kane dhene dakortesine dhe miratimin e shitjes se kuotes se ortakut Natasha Xhai Toka.

Neni 4: Çmimi i kontratës dhe kundërshtpërblimi

1. Vlera që shoqëria "Innovex" shpk do t'i paguajë Znj. Natasha Xhai Toka, për blerjen e kuotës së saj ne shoqerine "Green Living Company" shpk, do të jetë **ALL 50.000 (pesedhjete mijë) leke**.

Neni 5: Te drejtat dhe detyrimet

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate:
- a. Znj. Natasha Xhai Toka do të transferojë pronësinë totale 1 (nje) kuote te zoteruar në shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke në favor të shoqërisë "Innovex" shpk;
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Znj. Natasha Xhai Toka do të heqi dorë 1 (nje) kuote te zoteruar nga në shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke, pa pasur dhe/ose mbartur asnjë të drejtë dhe detyrim mbi këtë pjesë.
3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shoqëria "Innovex" shpk, bëhet **ortake** ne shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk dhe zoteruese 1 (nje) kuote në shoqerine "GREEN LIVING COMPANY" shpk, qe perfaqeson 50% (pesedhjete) të kapitalit te shoqerise, me vlere 50.000 (pesedhjete mijë) Leke. Si të tilla, kjo shoqëri merr përsipër të mbarte të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga ky transferim.



4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Znj. Natasha Xhai Toka, heq dore totalisht si ortakë e shoqërisë "GREEN LIVING COMPANY" shpk.
5. Bleresi është njohur me të gjitha detyrimet që vijnë nga ky transferim, dhe merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet e mëparshme si dhe është i gatshëm të perfitojë nga të drejtat që rrjedhin nga veprimet e mëparshme me këto pjesë të kuotes.
6. Shoqëria "Innovex" shpk merr përsipër të gjitha të drejtat, si dhe do të paguajë të gjitha detyrimet e mëparshme që vijnë nga cilësia e tij si ortak dhe zotëues i 1 (nje) kuote të në shoqërinë "GREEN LIVING COMPANY" shpk, që përfaqëson 50% (pesedhjetë) të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 50.000 (pesedhjetë mijë) Leke. Në momentin që do të vendoset shpërndarja e fitimeve (dividenteve) nga shoqëria "GREEN LIVING COMPANY" shpk, çdo detyrim tatimor për këto pjesë do të paguhet nga shoqëria "Innovex" shpk.

Neni 6: Dispozita të fundit

1. Palët e nënshkruese, bien dakord me dispozitat e kësaj kontrate, e cila hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga të gjitha këto palë.
2. Me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj marrëveshjeje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortakëria e shoqërisë "GREEN LIVING COMPANY" shpk do të përbehet nga ortakët si më poshtë:
 - a. Shoqëria "Innovex" shpk, ortakë zotëuese e 1 (nje) kuote, që përfaqëson 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 50.000 (pesedhjetë mijë) Leke.
 - b. Shoqëria "Texas Development shpk", ortakë zotëuese e 1 (nje) kuote, që përfaqëson 25 (njetëzet e pesë) % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 25.000 (njetëzet e pesë mijë) Leke.
 - c. Shoqëria "Daton" shpk, ortakë zotëuese e 1 (nje) kuote, që përfaqëson 25 (njetëzet e pesë) % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 25.000 (njetëzet e pesë mijë) Leke.
3. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë mes palëve, në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve. Vetëm në rast se sërish palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet, atëherë do t'i drejtohen Gjykatës së Shkalles së Pate të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

PALET NENSHKRUESE

PALA SHITËSE

Znj. Natasha Xhai Toka

NATASHA XHAI TOKA



PALA ORTAKE/DHENESE E PELQIMIT

Shoqëria "Daton" shpk

Admin. Z. Orion Cenalla



Orion Cenalla



Shoqëria "Texas Development" shpk

Admin. Z. Olsi Efthimi

Olsi Efthimi

Texas
Development

PALA BLERËSE

Shoqëria "Innovex" shpk

Admin. Z. Klevis Toka

KLEVIS TOKA